



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2754/ 3 prot

Datë 09.11.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN/SKUALIFIKIMIN E
OFERTUESVE TË TJERË DUKE REFERUAR VETËM KRITERET PËR TË CILAT
NGRIHEN PRETENDIME

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-78398-08-28-2023, me objekt: “Blerje kancelari per nevojat e OSHEE Group sh.a, OSSH sh.a, FSHU sh.a, FTL sh.a per nje vit” me fond limit 59,032,679.90 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 29.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK me NIPT J62426002Q dhe adresë: Kodër Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Shperndarjes se Energjise Elektrike Group sh.a me adresë: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H.1, Njësia Administrative Nr.7, 1023, Tiranë
- Subjekte të Interesuara:** Operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK me NIPT L91418502J dhe adresë: Durres, Zona Kadestrale nr.8517, e llojit trull plus ndertese 4 kate, me siperfaqe trualli 1’000 m2 dhe siperfaqe ndertese 330 m2, Durres, Spitalle.

Para publikimit të përmbajtjes së këtij formulari KPP sqaron se:

Në Sistemin e Ankesave Elektronike më datë 08.11.2023 është paraqitur ankesë e ardhur nëpërmjet shërbimit e-Albania me numër aplikimi A/2023/3579 dhe nr.2754 prot. datë 11.08.2023 ankesë e cila është aplikuar për procedurën e prokurimit me nr. REF-83206-10-11-2023 për Korporaten Elektroenergjitike Shqiptare Sh.a. Nga verifikimi rezulton se në brendesi të ankesës janë bashkëlidhur edhe një formular dhe nje mandat pagese për një procedurë tjetër me nr. REF-78398-28-2023 me autoritet Operatori i Shperndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a.

Me qëllim konfirmimin se për cilën procedure prokurimi është kryer aplikimi KPP përmes komunikimit elektronik zyrtar (e-mail) sot me datë 11.09.2023 ju drejtua me kërkesë operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK.

Në përgjigje të kërkesës më sipër të KPP-së sot me datë 09.11.2023 operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK ka konfirmuar se: *“Duke ju falenderuar për njoftimin tuaj nepermjet ketij e-mail-i, veme re se gjate ngarkimit te ankeses ne sistemin elektronik gabimisht kemi vendosur numrin e references per proceduren e zhvilluar nga AK Korporata Elektroenergjitike Shqiptare Sh.a, nderkohe qe ankesa jone i drejtohet vleresimit te procedures me AK Operatori i Shperndarjes së Energjisë Elektrike Group sh.a.*

Pra ju konfirmojme se ankesa jone i drejtohet procedures me objekt “Blerje kancelari per nevojat e OSHEE Group sh.a, OSSH sh.a, FSHU sh.a, FTL sh.a per nje vit” me REF-78398-08-28-2023, me fond limit 59,032,679.90 (pesedhjetë e nente milion e tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e shtatedhjetë e nente pike nentedhjetë)leke pa TVSH.

Lidhur me kete gabim kemi ngarkuar dhe nje shkrese per sqarim ne sistemin elektronik e-albania.”

Kjo përgjigje e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK u protokollua me tonën me nr. 2754/2 prot., datë 09.11.2023.

Për sa më sipër KPP do të publikojë përmbajtjen e formularit për publikim si më poshtë:

Në datën 08.11.2023, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3579 dhe nr.2754 prot., datë 08.11.2023 e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: *“Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/ skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”*

Komisioni i Prokurimit Publik publikon kriteret për të cilat operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK me anë të ankesës me numër ankimi elektronik A/2023/3579 dhe nr.2754 prot., datë 08.11.2023, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime për mospërmbushjen nga operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK të kriterëve si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënua për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.3 Operatori Ekonomik Ofertues duhet të provojë se disponon minimalisht **3 makina transporti** ne pronesi ose me kontrate qeraje, me afat kohezgjajtje per te gjithë kohen e vazhdimesise se kontrates, per kete duhet te paraqese dokumentacionin perkates sipas legjislacionit ne fuqi.

Mjetet e transportit duhet te jene te pajisura me dokumentacion perkates sipas legjislacionit ne fuqi (certifikat pronesie, leje qarkullimi, siguracion mjeti dhe certifikate e kontrollit teknik te mjetit).

Per te permbushur kriteret e mesiperm ne fazen e ofertimit, operatori ekonomik duhet deklaraje disponimin e makinave ne formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST.

Sqarim : Përmbushja e këtij kriteri në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST, sic parashikohet edhe nga pika 1 e nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, **ofertuesi i kualifikuar, i pari** duhet të dorëzojë dokumentat provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin).

2.4.4 Operatori ekonomik duhet të paraqese autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar ku ne cdo rast te dokumentohet lidhja e distributorit me prodhuesin, si dhe duhet të dorëzojë skedën teknike të prodhuesit ose ekuivalente. Kjo skede te jete e certifikuar nga prodhuesi ose distributori i autorizuar, ku te jene te pasqyruara karakteristikat dhe specifikimet teknike te tij per produktin **leter A4**.

Gjithashtu operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK pretendon se operatori ekonomik “Librari Dyrrahu” SHPK nuk ka argumentuar në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP cmimet anomalisht të ulëta të ofertuara në këtë procedurë prokurimi.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 09.11.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Fiorent Zguro